



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 799, Datë 06.05.2021

“Rrëzimi e kërkesës së shoqërisë FONDI BESA SHA për shfuqizimin e Vendimit nr. 772 datë 11.02.2021 ‘Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)’”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj.	Juliana LATIFI	Kryetar
Z.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Eduard YPI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Denar BIBA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.05.2021, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për sa i takon shoqërisë “Besa” SHA.

Baza Ligjore: Neni 24 germa d); neni 26, neni 42 dhe neni 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, mbi kërkesën e shoqërisë “Fondi Besa” SHA për shfuqizimin e Vendimit 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”,

VËREN SE:

Autoriteti bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka monitoruar tregun ku ushtrojnë veprimtarinë ekonomike subjektet financiare jo banka, konkretisht tregun e kredisë, mikrokredisë, qirasë financiare, faktoringut, shërbimit të pagesave dhe transfertave dhe parasë elektronike, të cilat rezultuan me karakteristikat e një tregu të përqendruar.

Në vijim të monitorimit Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003, me Vendimin nr. 712, datë 08.10.2020 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka”, ka vendosur hapjen e hetimit paraprak.

Pas mbledhjes së të dhënave dhe analizave të kryera gjatë hetimit paraprak Komisioni i Konkurrencës konstatoi se mund të ketë shenja të kufizimit të konkurrencës në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jo banka. Mbështetur në sa më sipër Komisioni i

Konkurrencës morri Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, për të verifikuar nëse ka shkelje të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”, ndërmarrja “Fondi Besa” SHA, me shkresën nr. 161/31 prot., datë 14.04.2021, ka paraqitur ankim administrativ për shfuqizimin e këtij vendimi. Nëpërmjet këtij ankimi drejtuar Komisionit të Konkurrencës ndërmarrja “Fondi Besa” SHA ka dhënë qëndrimin që ka lidhur me Vendimin nr. 772, datë 11.02.2021 që hap hetimin e thelluar në këtë treg.

Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e vendimit, sqarojmë se Vendimi nr. 772, datë 11.02.2021, që hap hetimin e thelluar është një vendim i cili në përmbajtje e tij përcakton ndërmarrjet ndaj të cilave do të sigurohet i gjithë informacioni i nevojshëm për të bërë analiza dhe vlerësuar nëse ka shkelje të ligjit nr. 9121/2003. Në përmbajtjen e vetë vendimit nuk ka asnjë sanksion që mund të cenojë ndonjë interes të ligjshëm të ndërmarrjeve.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit nr. 9121/2003, Komisioni i Konkurrencës është i detyruar që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës. Në përfundim të procedurës së hetimit të thelluar dhe pasi ka dëgjuar edhe palët Komisioni i Konkurrencës del me një vendim përfundimtar të mbështetur në provat, analizat e kryera dhe qëndrimet e palëve.

Për sa më sipër ankimi i ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA është i pabazuar në ligj, pasi neni 43 i ligjit nr. 9121/2003 ja njeh qartësisht këtë kompetencë Komisionit. Ligji i ka dhënë Autoritetit të Konkurrencës kompetencën e një institucioni hetues për të mbikëqyr tregjet ku mund të ketë shkelje të tij, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Nuk qëndron pretendimi i ankuesit për cenim të interesave të tyre të ligjshme ndërkohë që nuk kemi një vendim përfundimtar nga Komisioni i Konkurrencës.

Lidhur me pretendimet e ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA, për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 nuk i gjejmë të mbështetura në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24 germa d); nenit 26, nenit 42 dhe nenit 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar; Kodit të Procedurave Administrative.

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Fondi Besa” SHA për shfuqizimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 772, datë 11.02.2021 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka (SFJB)”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS